

KARTE TEKNOLOGJIKE PER PRODHIMIN E FIDANAVE TE ULLIRIT ME NEBULIZIM

Mënyrat e shtimit të fidanëve të ullirit janë disa por në këtë paketë do të trajtojmë metodën moderne të prodhimit të ullirit me anë të nebulizimit.

Shumëzimi i ullirit me metodën e nebulizimit ka disa avantazhe në raport me teknikën e shartimit sepse:

- Koha e prodhimit të fidanit është e reduktuar në një vit e gjysëm.
- Copat e gjelbra japin fidan me homogjen
- Në sipërfaqe të vogla prodhohet sasi e madhe fidanësh.
- Pemtoret e ngritura me keta fidane hyjne me shpejtë në prodhim.

Prodhimi i fidanëve të ullirit me nebulizim konsiston në përdorimin e copave të drynjëzuara dhe gjysëm të drynjëzuara të vendosura në substrat rrënjëzues dhe sipas një teknologjie që do e përshkuajm më poshtë.



Tipi i copes dhe përgatitja e saj: Kalemata për rrënjëzim merren nga parcelat mëmë të destinuara për këtë qëllim. Të përshtatëshme për shumëzim janë degëzat një vjecare, prej së cilës përdoren dy deri në tre seksione: seksioni i bazës, i mesit dhe i majës. Kalemi për rrënjëzim pritet me dy ndërnyje dhe me dy cifte gjethesh me gjatësi 12 – 15 cm në varësi të largësisë së ndërnyjeve.

Stimulimi: Bëhet me acidi indol butyric (IBA) me përqëndrim 2000-5000ppm dhe stimulohen për 5-6 sekonda.

Tufat thahen për rreth 30 minuta dhe më pas mbillen në bankot e rrënjëzimit të cilat më parë janë niveluar dhe vaditur.

Mbjellja: Bëhet me ndihmën e një vizoreje në distancë 2.5-3cm brënda rreshtit dhe 4-5cm rreshti nga rreshti duke mbjellë 1200-1300 kalema për m².

Substrati i rrënjëzimit: Perliti ka dhënë rezultate të mira në rrënjëzim, është një material granular, me porozitet mjaft të mirë për qarkullimin e ajrit dhe ruajtjen e sasisë së nevojshme të ujit.

Koha e rrënjëzimit: Është mjaft variable dhe në relacion të ngushtë me fiziologjinë e copës së gjelber. Nga provat e bëra gjat viteve është vërtetuar se përqidje më të lartë rrënjëzimi kanë patur copat e mbjella gjat pranverës (mars-prill) si dhe gjat vjeshtës (shtator-tetorë).

Temperatura: Temperatura në bazën e copave duhet të jetë 24 gradë pra disa gradë më lartë se temperatura e ambientit. Pas kallusimit dhe fillimit të rrënjëzimit temperatura ulet në 22 gradë.

Lagështia: Është e nevojshme të pengohet humbja e ujit nga gjethet deri sa të formohen rrenjët në bazën e eksplantit. Lagështia duhet të jetë më e madhe se 80%. Kjo arrihet me anë të mjegullës artificiale ku shtesa e hollë e ujit në sipërfaqen e gjethëve ul temperaturën rreth saj dhe temperaturën në indet qelizore deri në 8 gradë më ulët nga ambienti. Ujtja bëhet nepermjet sprucatoreve të cilët janë të vendosur 70-80cm mbi nivelin e gjethëve dhe hedhin 40-50 litra uje ne ore. Numëri dhe sasia e shihedhjes programohen automatikisht nëpërmjet panelit elektronik.

Shërbime të tjera në banko: Cdo 7-10 ditë duhet të bëhen trajtime kimike për të parandaluar kalbëzimin si dhe prekjen nga dëmtues të ndryshëm.

Pastrimi i perlitit nga gjethet e rena nuk duhet neglizhuar sepse ato janë burim i vazhdueshëm infeksioni.

Trapjantimi I. Trajtuar si më sipër copat rrënjëzohen për 60-65 ditë. Rrenjët marrin ngjyrë kafe në okër dhe në këtë moment janë gati për tu trapiantuar. Para mbjelljes 4-5 ditët e fundit kaliten duke ulur gradualisht temperaturën dhe lagështinë. Shkulja kryhet me dorë, me kujdes që të mos u dëmtohen rrenjët, vendosen në tava dhe transportohen në vendin e mbjelljes. Copat e rrënjëzuara mbillen në vazo të vogla me volum 0.5 l.

Substrati i trapjantimit të parë: torfë dhe rërë lumi e larë në raport (1:1). Copat pas mbjelljes sistemohen në serën e aklimatizimit. Ujiten menjëherë me ujë të bollshëm dhe më pas lagen gjethet 10-12 herë në ditë javën e parë. Më pas ndërpritet ky operacion. Ujitja e materialit bëhet cdo dite me ujitse shoshe.

Kryhen trajtime kimike me rridomil dhe dimetoat cdo javë. Temperatura në serën e kalitjes ruhet 26-28 gradë gjatë ditës, ndersa natën 22 gradë. Copat fillojnë të rriten dhe pas 45-60 ditë kur filizi arrin mbi 5-7 cm kjo bimë është e gatëshme për trapjantimin definitiv.

Trapjantimi II

Materiali i kalitur, trapjantohet në qeska polietileni zakonisht me dimensione 12x25 cm. Substrati mbjellës duhet të jetë i përshkueshëm me qëllim që të ajroset sistemi rrenjor, i pastër nga nematodat dhe dëmtues të ndryshëm, i pasur me element ushqyes. Nga praktika e QTTB Vlorë substratet që në përbërjen e tyre kanë dhe, shtufë dhe pleh kimik kanë dhënë rezultate të kënaqëshme në rritjen dhe zhvillimin e fidanit, me kosto të ulët.

Gjatë mbjelljes duhet bërë kujdes të mos priset buka e dheut. Pas mbjelljes qeskat vendosen në fushën e rritjes dhe menjëherë vaditen. Duke qënë se trapjantimi bëhet në muajt e verës kur temperaturat janë të larta dhe për pasoj dhe avullimi i lartë, ditët e para pas mbjelljes vaditjet bëhen më të shpeshta dhe më pas ato kryhen sipas nevojës pa lejuar që bimët të kalojnë stresë. Mënyra më e mirë e vaditjes është ajo me pika por edhe me sprucator në forëm shiu.

Shërbime të tjera pas mbjelljes deri në shitjen e fidanit:

Plehrime plotësuese me plehra kristalore në qeske ose plehrime gjethore cdo 10-15 ditë në periudhat kur bima është në aktivitet.

Heqja e sqetullorëve me qëllim që fidani të rritet në lartësi dhe kur ai arrin 70—80cm kujdesemi për formimin e kurorës. Gjatë ndërhyrjeve gërsëra dezinfektohet për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve të transmetueshme që prekin kulturën e ullirit.

-Pastrimin vazhdimisht nga barerat e këqia që konkurojnë bimën.

-Vendosja e kallëmbave mbështetës dhe drejtimi i fidanit.

Pergatiti

Lida Lazaj

Ramo Merkohitaj

